



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 604/8 prot.

Datë 14.04.2025

V E N D I M

Nr. 499/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “*REJ*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt “*Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec*” me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion milion pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjet e katër), zhvilluar në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “*4 A-M*” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik

të paraqitur nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “REJ” SHPK, me NIPT J93711608Q, me adresa: Sheshi “Evropa”, Pogradec.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “4 A-M” SHPK, me NIPT K92005016L dhe me adresë Tiranë, Rruga “Artan Lenja”, Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-rë.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a
Adresa: “Rruga e Gurasit”, Guras, Pogradec.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërsa operatori ekonomik ankimues “4-AM” Shpk, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së Formularit të Paraqitjes së Argumenteve pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.10.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt “Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njësisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion milion pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e katër), zhvilluar në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec sh.a.

II.2. Në datë 24.01.2025 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 12.02.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësimin e propozimeve ekonomiko-teknike dhe dhënien e pikëve operatorëve ekonomikë të kualifikuar, të procedurës së mësipërme të prokurimit, ku rezulton se:

1. ED KONSTRUKSION SHPK 994,078,490.95 lekë pa Tvsh Totali i pikëve 0 pikë
2. BOE “METEO” SHPK & “ALBA KONSTRUKSION” SHPK 976,603,789.85 lekë pa Tvsh Totali i pikëve 183.15 pikë
3. “4-AM” SHPK 933,316,598.75 lekë pa Tvsh Totali i pikëve 299.5 pikë
4. “REJ” SHPK 939,330,270.41 lekë pa Tvsh Totali i pikëve 258.90 pikë

II.4. Në datë 21.02.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 9, datë 24.02.2025, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “4-AM” SHPK.

II.5. Në datën 28.02.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5097 dhe me nr. 604/2025 prot, datë 01.03.2025 e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 604/1 prot., datë 01.03.2025, ku u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, si dhe kundërshtimin e kualifikimit dhe të vlerësimit me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “4-AM SHPK”, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në datën 03.03.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës”, të paraqitur në Sistemin e Ankesave Elektronike”, të protokolluar me tonën me nr. 604/2 prot, datë 03.03.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka refuzuar** ankesën e ankimuesit.

II.8. Më datë 04.03.2025, operatori ekonomik “4-AM SHPK, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentesh”, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, protokolluar me nr. 604/3 prot., datë 04.03.2025.

II.9. Me shkresën nr. 604/4 prot., datë 18.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec, që të dërgojë dokumentacionin e plotë fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “4-AM” SHPK, të njehsuar me origjinalin dhe të numerizuara nga ana e autoritetit kontraktor.

II.10. Me shkresën përcjellëse me nr. 241/1 prot., datë 06.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 604/5 prot., datë 26.03.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin, me shkresën përcjellëse “Dërgim dokumentacioni”, në lidhje me shkresën nr. 604/4 prot., datë 18.03.2025 të KPP-së.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, janë paraqitur argumentet nga OE i interesuar “4-AM” SHPK, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, nëpërmjet adresës elektronike të KPP-së, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “4-AM” SHPK me argumentimin se: *“Operatori 4AM shpk nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë të gjitha rubrikat e Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit shtojca 8, pasi nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me kërkesën: “Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontratë koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate”. Është detyrim i operatorëve të plotësojnë këtë rubrikë. Operatori “4AM” shpk nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë të gjitha rubrikat e Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit shtojca 8, pasi nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me kërkesën: “Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë”. Operatori 4AM shpk nuk ka dorëzuar vërtetimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve që provon se operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së (vertetim i gjendjes gjyqësore të subjektit). Operatori 4AM shpk nuk ka përmbushur detyrimin për dorëzimin e një vërtetimi i cili provon likuidimin e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike (Vërtetim lëshuar nga OSHEE/FSHU sh.a), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në kriteret e përgjithshme të kualifikimit shtojca 7 të dokumenteve standarde të tenderit kërkohet:

Shtojca 7.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

III.1.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, është parashikuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----

Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik			
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtërisë, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje

ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Për permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. . _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 2. . _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 3. . _____, me

	profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					

2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,

etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____
Firma _____
Vula _____
Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) në përmbushje të kriterit të kualifikimit, si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor, me shkresën përcjellëse me nr. 241/1 prot., datë 06.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 604/5 prot., datë 26.03.2025, konkretisht ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

-Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “4-AM” SHPK;

-Vërtetim me nr. 11 prot., datë 31.10.2024 nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektor i Gjendjes Gjyqësore, për subjektin “4-AM” Shpk;

-Vërtetim i gjendjes gjyqësore me nr. Kërkese 11 me datë 31.10.2024 nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për Z. A.M;

-Vërtetim me datë 18.07.2024 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për subjektin juridik/fizik “4-AM” Shpk;

-Vërtetim me datë 18.07.2024 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për Z. A.M;

-Vërtetim me datë 22.07.2024 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për subjektin juridik/fizik “4-AM” Shpk;

-Vërtetim me datë 22.07.2024 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për Z. A.M;

-Vërtetim debie nga Furnizuesi i shërbimit Universal me datë 15.01.2025 për subjektin “4-AM” Shpk, ku rezulton se ka shlyer detyrimet për faturat e energjisë elektrike, pa përfshirë faturën koherente të muajit Dhjetor 2024;

-Vërtetim debie nga Furnizuesi i shërbimit Universal me datë 03.02.2025 për subjektin “4-AM” Shpk, ku rezulton se ka shlyer detyrimet për faturat e energjisë elektrike pa përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2025;

III.1.4. Në nenin 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se; *Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*
1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; 27 gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. 28 Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 76 pika , pika 1, të ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: “1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

Në nenin 76 pika , pika 3, gërma “c” të ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

III.1.6. Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.7. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do

t'i dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit”.

Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse”.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik “4-AM” SHPK, në përmbushje të kriterit të kualifikimeve të përgjithshme kanë dorëzuar dokumentacionin e noterizuar të cituar në pikën III.1.3. Nga verifikimet e kryera nga dokumentacioni i administruar pranë autoritetit kontraktor konstatohet, se operatori ekonomik “4-AM” SHPK, ka dorëzuar për Shtojcën 8, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nga shqyrtimi i të cilit rezulton, se në pjesën e parë të tij është dhënë informacioni në lidhje me administratorin. Referuar formularit, i cili është një provë paraprake mbi kërkesat të cilat ky formular përmban, në rastin konkret ndodhemi para faktit ku operatori ekonomik i kualifikuar i pari dorëzon pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues lidhur me Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas ligjit për Prokurimin Publik 162/2020, i ndryshuar, përkatësisht nenit 82, pikës 5. *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të, cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre; b) dokumentet mbështetëse në original ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, “4-AM” SHPK, (pjesë e ofertës së dokumentacionit të dorëzuar pranë Autoritetit kontraktor), rezulton se kjo shoqëri, në cilësinë e administratorit të vet dhe të ortakut të vetëm, ka Z. A.M. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor konstatohet, se operatori ekonomik “4-AM” SHPK ka dorëzuar, vërtetim nga Drejtoria e

Përgjithshme e Burgjeve, për Subjektin “4-AM” SHPK, ku rezulton se subjekti “4-AM” Shpk me NIPT K92005016L është i padënuar. Ky vërtetim është lëshuar më datë 31.10.2024. Gjithashtu, Komisioni vëren, se operatori ekonomik “4-AM” SHPK ka dorëzuar Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, që nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik për administratorin dhe ortakun e shoqërisë, në përmbushje të kriterit të përgjithshëm. Ndërsa në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të energjinë elektrike operatori ekonomik “4-AM” SHPK ka dorëzuar -Vërtetim debie nga Furnizuesi i shërbimit Universal me date 15.01.2025 për subjektin “4-AM” Shpk, ku rezulton se ka shlyer detyrimet për faturat e energjisë elektrike pa përfshirë faturën koherente të muajit Dhjetor 2024; Vërtetim debie nga Furnizuesi i shërbimit Universal me date 03.02.2025 për subjektin “4-AM” Shpk, ku rezulton se ka shlyer detyrimet për faturat e energjisë elektrike pa përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2025, duke plotësuar kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dt. 24.01.2025, nuk ka detyrime të papaguara, pasi sipas nenit 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht se: “Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit, si dhe 31 legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do t’i dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit..”, ndërsa në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit, si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “4-AM” SHPK përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për paraqitjen e dokumentacionit në përmbushje të kërkesave të formularit të vetëdeklarimit, ku ortaku apo administratori nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose nuk ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Vendosja e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën

e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

-Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “REJ” Shpk, mbi mospërmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pra sipas shtojcës 8 të DT, nga ana e ofertuesit “4-Am” Shpk. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në formularin e ankesës së dorëzuar nga ankimuesi, ky i fundit nuk ka arritur të shprehë në mënyrë të qartë pretendimin e tij në lidhje me plotësimin e plotë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit të ofertuesit “4-AM” Shpk sipas shtojcës 8 të DT. Për arsye se, në fillim pretendon për mos plotësim të të gjithë rubrikave të FPV dhe pastaj për disa rubrika. KPP vlerëson të mos i marrë në shqyrtim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ofertuesit “4-AM” Shpk, pra sipas shtojcës 8 të DT, të sipërpërmendura nga operatori ekonomik “REJ” ShPK.

-Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

- Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

- KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

-Në lidhje me pretendimin për mosdorëzim të vërtetimit të pagesës për të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në

fuqi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “4-AM” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor një vërtetim të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti “4-AM” SHPK nuk rezulton debitor, pa përfshirë muajin e fundit ende të pamaturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, datë 24.01.2025. Gjithashtu, KPP gjykon, se institucioni i Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “4-AM” SHPK me argumentimin se: *“Operatori 4AM shpk nuk plotëson nënpikën 6 të pikës 2.3.7 të Kapacitetit Teknik “Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës”, pasi ky operator mjetet e deklaruar në formularin përmbledhes së vetdeklarimit shtojca 8 i ka të angazhuara në kontrata të tjera e konkretisht në Kontratën që ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Dorëzimi i deklaratës nga ky subjekt se mjetet do jenë të disponueshme që zbatimit të kontratës është në kushtet e deklarimit të rremë për qëllime kualifikimi pasi mjetet e deklaruar në shtojcën 8 janë të angazhuara pranë kontratave të cituara mësipër. Operatori 4AM shpk nuk plotëson kriterin e nënpikës 6 të kriterit 2.3.7 të Kapacitetit Teknik të DT-ve, pasi nuk ka paraqitur deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 7/2 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.7. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, modifikuar me anë të shtojcës datë 30.12.2024, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:*

Nr	Mjetet	Sasi a	Gjendj a	Volumet
1	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 18 – 20 ton	3 Cope	Pronësi ose me qera	286061m3 germim 65701 m3 transport
2	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 20 ton	3 cope	Pronësi ose me qera	286061m3 germim 65701 m3 transport
3	Eskavator me zinxhir me kove 0.3 m ³	2 Cope	Pronësi ose me qera	286061m3 germim
4	Eskavator me krah te gjate min 12m	2 Cope	Pronësi ose me qera	286061m3 germim
5	Kamionçine me kapaciteti mbajtës 2-4 ton	5 cope	Pronësi ose me qera	61694 m2 prishje betoni, guri 10025 ml tubo Φ te ndryshme F.V puseta 1923 cope
6	Fadrome me goma me kove para dhembrapa	3 copë	Pronësi ose me qera	Per mbushje me dhe dhe materiale ndertimi
7	Eskavator me goma me kove 0.25 m ³	2 Cope	Pronësi ose me qera	Per germime te vogla 57212 m3 germim dheu
8	Autovinc me kapacitet min 10 Ton	2 Cope	Pronësi ose me qera	16781 m2 Mbrojtja e Kanalit Me Palankola per thellesi >1.7m deri 6m
9	Rrul hekuri per ngjeshje deri ne 2 Ton	1 cope	Pronësi ose me qera	Per ngjeshjen e pjeseve te hapura nga germimi per instalimin e tubacionit
10	Autofshese per asfaltin	1 Cope	Pronësi ose me qera	Per kthimin ne gjendjen fillestare te siperfaqeve asfaltike ku do te ndryshet sipas preventivit.

11	Prerese Asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera	61694 m2 prishej shtresa asfalti betoni guri
12	Asfaltoshtuese	1 Cope	Pronësi ose me qera	Per rehabilitimin e siperfaqeve asfaltike ku do te nderyhet sipas preventivit
13	Autobitumatrice	1 Cope	Pronësi ose me qera	Per rehbilitimin e siperfaqeve asfaltike ku do te nderyhet sipas preventivit
14	Rrul Vibrues Gome – Hekur (me kapacitet9 – 12Ton)	1 Cope	Pronësi ose me qera	65701 m 3 mbushje dheu
15	Paisje per ngjitjen e Tubave HDPE -613mm	3 Cope	Pronësi ose me qera	
16	Paisje per testimin e linjese se tubave me presion	1 cope	Pronësi ose me qera	
17	Minifadrome me kove para	2 cope	Pronësi ose me qera	Per mbushje me dhe dhe materiale ndertimi te imta ne pjese rruge me akses te limituar pasi mjetet e tjera nuk mund te punojne
18	Well Point ITT	2 Cope	Pronësi ose me qera	Per punimet ne stacioin e pompimit Lin i cili eshte ne afersi te bregut te liqenit si edhe per hapjen e themeleve per dekantuesit
19	Matrapik me fuqi min 2000Ë	2 cope	Pronësi ose me qera	61694 m2 prishje asfalti betoni
20	Motogjenerator me fuqi min 200 kVA	2 cope	Pronësi ose me qera	61694 m2 prishje asfalti betoni
21	Autokulle per ndricimi kantier	1 cope	Pronësi ose me qera	
22	Makineri per nguljen e palankolave	1 Cope	Pronësi ose me qera	

23	Trencher me zinxhir per hapje kanali fuqimin 180 kË	1 cope	Pronësi ose me qera	
24	Total station + GPS	1Cope	Pronësi ose me qera	Per shkak te gejojgrafise se objektit ne total duhen 1 total station +1 GPS, per percaktimin e sakte te vendodhjes ne plan dhe ndjekjes se pjerresive.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

1. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
2. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qera (e vlefshme).
3. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
4. Për fabriken e pushtave nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerave. Operatori ekonomik per fabriken e pushtave mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit sipas dokumentacionit me lart te kerkuar.
5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës.
6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga dokumentacioni fizik i dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor rezulton, se operatori ekonomik ofertues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “**4-AM**” SHPK, me datë 24.01.2025.

-dokumentacion fizik i njehsuar me origjinalin të mjeteve që disponon në përmbushje të kriterit 2.3.7 të DT;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.2.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend*

të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.2.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. **Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve ²të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike³. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” si dhe ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterëve të kualifikimit të vetëdeklaruar në shtojcën 8, ku deklaroi mjetet dhe makineritë, referuar kriterit të parashikuar në pikën 2.3.7 të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik ka deklaruar në shtojcë (Llojin e mjetit, Targën e mjetit, Nr. Lejes qarkullimit të mjetit, Nr. Shasisë së mjetit, Nr. Kontratës Qirasë, Afati i Kontratës Qerasë, duke evdidentuar:

<i>Nr</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>	<i>OE 4-AM SHPK, dokumentacioni shoqërues</i>
1	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 18 – 20 ton	3 Cope	Pronësi	Mjeti AB491OG, a)mungon dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AB850HH a)mungon dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AB864HH a)mungon dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c)

				çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme);
2	Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 20 ton	3 cope	Pronësi	Mjeti AB858OH a) mungon dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AB857OH a) mungon dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AB838OH a) mungon dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme);
3	Eskavator me zinxhir me kove 0.3 m ³	2 Cope	Pronësi	Faturë tatimore nr. 10001741/2023; foto, Faturë tatimore nr. 10001751/2023; foto
4	Eskavator me krah te gjate min 12m	2 Cope	Pronesi	Akt zhdoganimi R130658, datë 12.12.2018. Akt zhdoganimi R118869, datë 14.11.2018.
5	Kamionçine me kapaciteti mbajtës 2-4 ton	5 cope	Pronësi	Mjeti AA882PM a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AA542UH a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit

				(akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AA964DK a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AA361RE a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AA367NS a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); -secili mjet shoqëruar me foto
6	Fadrome me goma me kove para dhe mbrapa	3 copë	Pronësi	Mjeti AHMT05 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti ABMT72 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme);

				Mjeti AIMS92 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); -secili mjet shoqëruar me foto
7	Eskavator me goma me kove 0.25 m ³	2 Cope	Pronësi	Mjeti AKMT18 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AKMT63 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); -secili mjet shoqëruar me foto
8	Autovinc me kapacitet min 10 Ton	2 Cope	Pronësi	Mjeti AA465PC a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AB325CT a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); -secili mjet shoqëruar me foto
9	Rrul hekuri per ngjeshje deri ne 2 Ton	1 cope	Pronësi	Akt zhdoganimi R15312, datë 04.03.2016, foto
10	Autofshese per asfaltin	1 Cope	Pronësi	Mjeti AKMT55 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit

				(akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); - mjet shoqëruar me foto
11	Prerese Asfalti	2 cope	Pronësi	Faturë tatimore, 2 copë, foto
12	Asfaltoshtruese	1 Cope	Pronësi	Akt zhdoganimi R42156, datë 02.05.2023, foto
13	Autobitumatrice	1 Cope	Pronësi	Mjeti AB281AZ a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); - mjet shoqëruar me foto
14	Rrul Vibruës Gome – Hekur (me kapacitet 9 – 12Ton)	1 Cope	Pronësi	Akt zhdoganimi R128018, datë 28.10.2017, foto
15	Paisje per ngjitjen e Tubave HDPE - 613mm	3 Cope	Pronësi	Akt zhdoganimi + faturë shitje, foto
16	Paisje per testimin e linjese se tubave me presion	1 cope	Pronësi	Faturë tatimore nr. 11, datë 20.02.2020
17	Minifadrome me kove para	2 cope	Pronësi	Mjeti AFMT46 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AJMT37 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); -secili mjet shoqëruar me foto
18	Ëell Point ITT	2 Cope	Pronësi	Akt zhdoganimi + faturë shitje, foto

19	Matrapik me fuqi min 2000Ë	2 cope	Pronësi	Akt zhdoganimi + faturë shitje, foto
20	Motogjenerator me fuqi min 200 kVA	2 cope	Pronësi	Akt zhdoganimi + faturë shitje, foto
21	Autokulle per ndricimi kantier	1 cope	Pronësi	Mjeti AGR348 a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); - mjet shoqëruar me foto
22	Makineri per nguljen e palankolave	1 Cope	Pronësi	Akt zhdoganimi + faturë shitje, foto
23	Trencher me zinxhir per hapje kanali fuqi min 180 kË	1 cope	Pronësi	Akt zhdoganimi + faturë shitje, foto
24	Total station + GPS	1Cope	Pronësi	Faturë tatimore nr. 159, datë 07.03.2018

III.2.10. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se operatori ekonomik në lidhje me deklarin e të dhënave të mjeteve, nga verifikimi i shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” rezulton se e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.7. Për sa i përket mjeteve të pretenduara nga operatori ekonomik ankimes që nuk disponojnë dokumentacionin të rregullt sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “4-AM” SHPK ka deklaruar duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara në tabelën e mjeteve me qera/pronësi, tek seksioni respektiv të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur si dhe autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionit fizik të njehsuar me origjinalin e dorëzuar nga ana e subjektit fitues shoqëruar me dokumentacion plotësues.

KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “4-AM” SHPK rezulton, se

1. Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 18 – 20 ton: **Mjeti AB491OG**, a) mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); **Mjeti AB850HH** a) mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); **Mjeti AB864HH** a) mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme);
2. Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 20 ton: **Mjeti AB858OH** a) mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport

mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AB857OH a) mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme); Mjeti AB838OH a) mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme);.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik i OE “4-AM” Shpk të dërguar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, Komisioni evidentoi të gjitha mjetet e deklaruara në pronësi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të OE “4-AM” Shpk, ku konstatoi se deklaratimet e dhëna në këtë formularë, janë të sakta dhe mbështeten nga dokumentacioni fizik i ofertuesit. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “REJ” Shpk, që nuk është dorëzuar dokumentacioni i vlefshëm për mjetet e deklaruara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Komisioni konstatoi se, për mjetet Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 18 – 20 ton dhe Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 20 ton, mungon dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), por nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të OE “4-AM” Shpk, të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni konstaton se, nuk është dorëzuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 1 të kriterit 2.3.7 “dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë”, por ka dorëzuar dokumenta të tilla si leje qarkullimi; certifikatë e kontrollit teknik; siguracion mjeti, (i vlefshëm); certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme). Sa më sipër, Komisioni gjykon se, për sa kohë që informacioni në lidhje me pronësisë të mjetit merret edhe nga leja e qarkullimit të mjetit respektiv konkretisht pika “, C.2 Prani i Mjetit”, ashtu edhe nga dokumnetta e tjera bashkëlidhur për mjetin përkatës, konsiderohet i përmbushur si kriter, për sa kohë që, autoriteti kontraktor merr të gjithë informacionin e kërkuar mbi të dhënat e cituara në lidhje me pronësisë të mjetit. Gjithashtu, referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “REJ” Shpk, në lidhje me pikën 6 të kriterit 2.3.7 të mjeteve për mos dorëzim nga ana e operatorit ekonomik “4-AM” SHPK. Nga shqyrtimi i dokumentacioni të dorëzuar në SPE nga ky i fundit si edhe nga informacioni i dhënë nga autoriteti kontraktor, në dokumentacion fizik i njehsuar me origjinalin të mjeteve që disponon në përmbushje të kriterit 2.3.7 të DT, Komisioni evidentoi se operatori ekonomik “4-AM” SHPK ka paraqitur një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të bëjë deklarinimin e adresës së saktë të vendodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “4-AM” SHPK, ka provuar se disponon mjetet e kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “REJ” SHPK duke kundërshtuar vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “4-AM” Shpk, me argumentin se: *“...Duke qënë të bindur se vlerësimi i ofertës tonë me 258.90 pikë nuk paqyron vlerësim të drejtë nga ana e KVO për ofertën tonë në raport me dokumentacionin e paraqitur si dhe vlerën e ofertës të ofertuar nga ana jonë, po i drejtohem më këtë ankim AK dhe KP, duke kundërshtuar*

vendimin mbi vlerësimin e ofertës tonë me 258.90 pikë dhe kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit 4 AM shpk me 299.50 pikë.

Ndërsa vlerësimi për nënkriterin “b” Faktorët Favorizues, oferta e Rej shpk është vlerësuar në total me 5 pikë dhe po me 5 pikë është vlerësuar oferta e shoqërisë “4AM” shpk. Vlerësimi me 5 pikë i ofertës së operatorit “4AM” shpk është i padrejtë dhe subjektiv pasi ky subjekt nuk ka paraqitur me dokumentacion asnjë risi, faktor favorizues ose ndonjë pajisje inovative si dhe paraqitjen e ndonjë metodologjie punimesh që të favorizojë kohën në realizimin e punimeve,

-Operatori ekonomik 4AM shpk ka dështuar të plotësojë këtë kërkesë pasi nuk ka paraqitur një analizë të mirëfitlltë të makinerive që do të angazhojë për secilin proces pune ose më e pakta ajo analizë që ka dorëzuar nuk plotëson kushtet për tu pikëzuar me maksimumin e pikëve. Gjithashtu e njëjta gjë vlen edhe për analizën për numrin e përafërt të punonjësve që do të angazhjë në çdo proces pune,

-gjykojmë se subjekti 4AM shpk duhet të vlerësohet me pikë më pak se operatori Rej shpk lidhur me nënkriterin e pikës 2 “Dëshmi që stafi disponon kualifikime universitare [3 pikë]” pasi operatori 4AM shpk nuk ka paraqitur staf i cili përveç diplomimit të këtë kryer dhe kualifikime universitare në fushat përkatëse që kanë lidhje me objektin e prokurimit.

-Subjekti 4AM shpk duhet të vlerësohet me pikë më pak se operatori Rej shpk lidhur me nënkriterin e pikës 3 “Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit [3 pikë]” pasi operatori 4AM shpk ka paraqitur staf i cili referuar viteve në punë kanë më pak vite eksperiencë punë se stafi i paraqitur nga operatori Rej shpk.

Kësisoj për këtë nënkriter operatori ekonomik 4AM shpk duhej të vlerësohej me pikë minimale dhe jo maksimale. Gjithashtu, Subjekti 4AM shpk duhet të vlerësohet me pikë më pak se operatori Rej shpk lidhur me nënkriterin e pikës 4 “Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashmërisë me kontratën që prokurohet [6 pikë]” pasi operatori 4AM shpk ka paraqitur staf i cili referuar natyrës së punës apo kompleksitet të ngjashmërisë me natyrën e kontratës që prokurohet nuk kanë asnjë gjë të përafërt apo të përbashkët. Kësisoj për këtë nënkriter operatori ekonomik 4AM shpk duhej të vlerësohej me pikë minimale dhe jo maksimale. Lidhur me nënkriterin e pikës “b4” dhe të fundit për këtë kriter “Skema e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0-2 pikë]”, rezulton se operatori 4AM shpk duhej vlerësuar me pikë minimale për këtë nënkriter pasi ka një mospërputhje ndërmjet mungesës së përvojës lidhur me vitet dhe eksperiencën së stafit dhe nuk mund të këtë një skeme organizimi të tyre që të meritojnë maksimumin e pikëve.

- Ne jemi të bindur se OE 4AM shpk nuk ka dorëzuar fare dokumentacion për nënkriterin “a” e “b” të kësaj pikë, ose edhe nëse ka dorëzuar dokumentacion ai nuk i përgjigjet propozimeve konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore si dhe propozimeve konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, kreu I “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 25 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, parashikon:

25 Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1 Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

III.3.2. Në dokumentet e tenderit, Seksioni 4.4, “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto ⁴X

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit □ □	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanisë □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □ □	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit □ □	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike)

⁴Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

kohën e propozuar (**jo më shumë se 24 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]
 - I Kohën e mobilizimit në kantier (jo më shumë se 3 muaj) [2 pikë].
 - II Grafiku i punimeve të Kontratës. [13 Pikë]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizën e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k2a}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k2a}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2a}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin **2.3** / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

- I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime universitare [3 pikë]

Për sa më sipër në mbështetje të vendimit nr. 1632/2024 datë 19.12.2024 dhe nr. 1719/2024 datë 06.12.2024 Autoriteti Kontraktor argumenton se: **Dëshmi që stafi disponon diplomë universitare (bachelor + master) për stafin inxhinierik të Shoqërisë.**

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë].

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit [6 pikë].

Për përmbushjen e kriterëve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njera-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

3. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

4. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

***Shënim – Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret) duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.**

III.3.3. Në përmbushje të kriterëve vlerësues për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Oferta ekonomike ;
2. Përvoja e kompanisë dhe dokumentacion provues;
3. Plani i mobilizimit dhe metodologjia e punimeve;
4. Analiza e mjeteve dhe Grafiku i fuqisë punëtore;
5. Plani i menaxhimit të emergjencave;
6. Plani i menaxhimit të trafikut;
7. Plani i sigurimit të cilësisë;
8. Plani i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;
9. Dokumentacion teknik mbi stafin teknik të propozuar;

Nën-kriteri:

a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

N r.	Stafi inxhinierik	REJ Shpk	Vite eksperiencë	III. Deshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pike]				b..Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]
				I. Deshm i që stafi ploteson vetem kushtet e kriterëve të vecant e të kualifikimit për stafin [1 pike]	II. Deshm i që stafi dispon on kualifi kime univer sitare [3 pike]	III. Deshmi që stafi dispono n eksperie nce ne vite pune mbi nivelin minimal te kerkuar ne kushtet e vecanta te kualifiki mit per stafin [3 pike]	IV. Deshmi që stafi disponon eksperience ne natyre/kom pleksitet te ngjashme me kontraten e prokurimit. [6 pike]	
			Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV,	1	3	3	6	2
1	1 (nje)Inx hinier	3	Ing. Ndërtimi Tod Buzo, diplomë, kontrata e punës individuale nr. Rep 212 nr. Kol, 123, datë 01.02.2024	47+3 7+6				

	Ndërtimi		dhe librezë punës. Ing. Ndërtimi Ylli Agolli (Kozica), diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 208 nr. Kol, 119, datë 01.02.2024 dhe librezë punës. Ing. Ndërtimi Ermira Xhaja, diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 207 nr. Kol, 118, datë 01.02.2024 dhe librezë punës.						
2	1 (një) Inxhinieri Hidroteknik	1	In. Hidroteknik Diana Oshafi, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 77 nr. Kol, 39, datë 16.01.2024 dhe librezë punës	37					
3	1 (një) Inxhinieri Mekanik	2	Ing. Mekanik Dhimitër Mihilli, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 205 nr. Kol, 116, datë 01.02.2024 dhe librezë punës. Ing. Mekanik Ylli Hamzallari, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 1959 nr. Kol, 1034, datë 09.09.2024 dhe librezë punës	46+3 2					
4	3 (tre) Inxhinieri Topograf	3	Ing. Topograf Abdi Xhetani, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 550 nr. Kol, 367, datë 28.08.2024 dhe librezë punës. Ing. Topograf Luan Lipo, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 640 nr. Kol, 317 datë 11.04.2024 dhe librezë punës. Ing. Topograf Sherif Sulejmani, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 777 nr. Kol, 449 datë 28.02.2024 dhe librezë punës	57+3 3+15					

5	1 (një) Inxhinier Elektrik	1	Ing. Elektrik Niko Urumi, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 705 nr. Kol, 352, datë 18.04.2024 dhe librezat punës	44					
6	1 (një) Inxhinier Mjedisi me VNM	1	Ing. Mjedisi Florenc Gora, Diplomë, Cv, librezat punës	25					

10. Shtojcat;
11. Katalogët dhe certifikatat ISO të kompanisë;
12. Aneks 2-periudha e garancisë;
13. Sigurimi i Ofertës;
14. Licenat;

II.3.4. Në përmbushje të kriterëve vlerësuesë për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, operatori ekonomik, si subjekt i interesuar, konkretisht “4-AM” SHPK, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Certifikata ISO;
2. Dokumentacion ligjor dhe ekonomik (certifikata, vërtetime, xhiro, bilance)
3. Deklaratat;
4. Licencat e kompanisë;
5. Përvoja e kompanisë dhe dokumentacion provues;
6. Katalogë dhe autorizime prodhuesi;
7. Oferta ekonomike;
8. Sigurimi i ofertës;
9. Grafik punimesh;
10. Propozimi teknik;
11. Ankesi 2-periudha e garancisë së objektit;
12. Aneksi 3-Stafi dhe organizmimi i kontraktorit;

Nën-kriteri:

a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperienca në fushen specifike [13 pikë]

N r.	Stafi inxhinierik	4-A M Shpk		Vite eksperiencë				b..Ske ma e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]
				I. Deshmi qe stafi ploteson vetem kushtet e kriterëve të vecante të kualifikimit per stafin [1 pike]	II. Deshmi qe stafi disponon kualifikime universitare [3 pike]	III. Deshmi qe stafi disponon eksperience ne vite pune mbi nivelin minimal te kerkuar ne kushtet e vecanta te kualifikimit per stafin [3 pike]	IV. Deshmi qe stafi disponon eksperience ne natyre/kompleksitet te ngjashme me kontraten e prokurimit. [6 pike]	
			Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV,	1	3	3	6	2
1	1 (nje)Inxhinier Ndërtimi	1	Ing. Ndërtimi Elis Habibi, diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 6064 nr. Kol, 2079, datë 01.11.2024 dhe librezë punës	16				
2	1 (një) Inxhinier Hidroteknik	1	In. Hidroteknik Gentian Dokle, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 6067 nr. Kol, 2082, datë 01.11.2024 dhe librezë punës	15				
3	1 (një) Inxhinier Mekanik	1	Ing. Mekanik Elez Ahmetaj, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 2233 nr. Kol, 743, datë 24.04.2024 dhe librezë punës	46				
4	3 (tre) Inxhinier Topograf	3	Ing.Gjeodet Blerim Koci, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 6068 nr. Kol, 2083, datë 01.11.2024 dhe librezë punës. Ing. Gjeodet Elio Dodaj, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale datë 01.03.2024 dhe librezë punës. Ing. Gjeodet Klevis Marku, Dilpomë, Cv, kontrata e punës	14,5,6				

			individuale datë 01.03.2024 dhe librezë punës					
5	1 (një) Inxhinier Elektrik	1	Ing. Elektrik Iljan Metaliaj, Diplomë, Cv, kontrata e punës individuale nr. Rep 6063 nr. Kol, 2078, datë 01.11.2024 dhe librezë punës	1 0				
6	1 (një) Inxhinier Mjedisi me VNM	1	Ing. Mjedisi Bledar Alstafa, Diplomë, Cv, dhe librezë punës.	1 4				

13. Aneksi 4- Metodologjia e ndërtimit;
14. Aneksi 5-Plani i menaxhimit të trafikut;
15. Aneksi 6- Plani i menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS);
16. Aneksi 7- Plani i sigurisë në kantier;
17. Aneksi 8- Plani i mbrojtës së sigurisë , shëndetit dhe jetës;
18. Aneksi 9- Programi i sigurimit të cilësisë;

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të

këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në

dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.6. Në nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

III.3.7. Në nenin 88 “Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:

a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:

i. kostot që lidhen me blerjen;

ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;

iii. kostot e mirëmbajtjes;

iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.

b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik.

2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.

Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) bazohet mbi kriteret objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese.

b) nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;

c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;

ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.

III.3.8. Neni 47 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.
2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.
 - 2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:
 - a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftimeve Publike;
 - b) elementet fiskale;
 - c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës .
3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.
4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:
 - a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose
 - b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose
 - c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.
5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:
 - a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose
 - b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.
6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

III.3.9. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si Çmimi (50 pikë), Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit (20 pikë), Stafi/organizimi i kompanisë (15 pikë), Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social (0-10 pikë), Periudha e garancisë së objektit (0-5 pikë)sipas dokumenteve standarde të tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe metodologjia □□	pikët 15
Stafi / Organizimi i Kompanisë □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□	pikët 10
Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit □□	pikët 10

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë të ofertës ekonomike më të favorshme, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet t'i nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dyplanëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët e tjerë ekonomikë, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime.

Kriteri:

III.3.10. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (jo më shumë se 24 muaj). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a.-Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pikë].

II Grafiku i punimeve të Kontratës. [13 Pikë]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{mink2a} \times P_{maxk2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink2a} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk2a} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b.-Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

b.-Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

Treguesit dhe analiza cilësore (Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve-objekt prokurimi), duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket aktorët favorizues, pajisjet inovative dhe metodologjitë e punimeve që mund të favorizojnë kohën e realizimit të punimeve përfshijnë një gamë të gjerë aspektesh që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit të ndërtimit ose realizimit të projektit. Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet t'i nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (propozimit teknik ose metodologjia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta ekonomike më e favorshme, lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së punës, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe metodologjia që favorizojnë kohën e realizimit të punimëve, faktorët favorizues si pajisjet inovatore zgjidhjet teknike për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të peshojë me 0-5 pikë. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Por nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik/ofertues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Në lidhje me nënkriterin faktori favorizues/pajisje inovative, ku referuar dokumentet e procedurës së prokurimit-specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, ku është përcaktuar se realizimi i punimeve do të kryhet referuar specifikime teknike civile dhe të veçanta të hartuara nga ana e autoritetit kontraktor por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, pajisje inovative, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "4-AM" SHPK dhe "REJ" Shpk si edhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), Komisioni konstaton se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë paraqitur materiale për nënkriterin-faktori favorizues, ku në rastin

konkret OE “4-AM” Shpk ka paraqitur dokumentacionin, si vijon: Propozimi teknik_Pjesa e 1, një matrial prej 62 faqesh ku në Aneksin 4- Metodologjia e ndërtimit, është bërë një përshkrim narrativ mbi qëllimin e tij, struktura organizimit në staf në nivel qëndror dhe nivel kantieri si dhe anagzhimi i mjeteve, cilësia dhe sigura gjatë fazës së implelementimit të projektit, një përshkrim procedural mbi hapat që do të ndiqen për metodologjinë e punimeve për tubat korrogate HDPE, të testimit të tubacioneve dhe masat e menaxhimit të trafikut. Duke iu referuar nënkriterit *Faktorët favorizues, pajisjet inovative dhe metodologjitë e punimeve që mund të favorizojnë kohën e realizimit të punimeve* përfshijnë një gamë të gjerë aspektesh që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit të ndërtimit ose realizimit të projektit siç janë: pajisjet inovative, metodologjia e punimeve, stafi dhe mjetet, pajisjet dhe materialet e përshtatshme. Pra si përfundim, përdorimi i pajisjeve të reja, qasjet inovative dhe përmirësimi i menaxhimit të komunikatës dhe koordinatës janë disa nga mënyrat kryesore që mund të kontribuojnë në një realizim më të shpejtë dhe me cilësi të lartë të projektit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, Komisioni evidentoi që në seksionin metodologjinë e punimeve për tubat korrogate HDPE, kemi një përshkrim narrativ për metodologjinë që do të aplikohet në procedurat teknike të punës për këtë projekt. Konkretisht, në paragrafin, 1.6 “Vendosja e jashtëme”, cilësohet se në lidhje me pajisjet e nevojshme për të bërë lidhjen me tubacionin ekzistues, do të përdoren priza (balona) për ndarjen e kanalizimeve të reja dhe ato ekzistuese, derisa linja e re e kanalizimit të jetë gati për t’u vënë në punë. Në paragrafin 1.11 “Lidhja me tubacionet ekzistuese”, cilësohet se në lidhje me pajisjet e nevojshme për të bërë lidhjen me tubacionin ekzistues, kontraktori do të përdorë lokalizues tubash ose mjete të ngjashme për të përcaktuar më saktë pozicionin e tubave ekzistues ndërsa për prerjen e rrjetit ekzistues do të përdoren pajisje speciale të miratuara nga inxhinieri, por Komisioni konstaton se subjekti që do të realizojë punimet nuk ka përcaktuar se cilët mjete inovatore do të përdorë. Ndërsa, në paragrafin 1.12. “Lidhjet e shtëpive” cilësohet se të gjitha lidhjet e shtëpive duhet të lidhen më linjë kryesore të kanalizimeve nëpërmjet një shale trokitje (tipi 3). Shala e trokitjes që do të përdoret do të jetë “Easyclip city”.

Gjithashtu, OE “4-AM” SHpk, në lidhje me Aneksi 5- Plani i Menaxhimit të Trafikut në fazën e zhvillimit të projektit të zbatimit, është e një rëndësie të veçantë, për shkak se të gjitha pothuajse aktivitetet/punimet e saj do të zhvillohen në afërsi të zonës administrative Njësia Udenisht (Udenisht, Memlisht, Bukeze, Lin, Piskupat, Lin stc pompave), ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve dhe fluksi do të jetë mesatare. Prandaj dhe të gjithë personat e përfshirë në këtë proces do të jene të mirë informuar dhe të kualifikuar. Për këtë arsye janë renditur edhe disa masa të përgjithshme për operimin dhe sigurinë gjatë fazës së ekzekutimit të punimeve. Për të gjitha planet e menaxhimit të trafikut, stafi i angazhuar në kontratën ku do të jetë prezent gjatë fazës së ekzekutimit të punimeve, do t’i referohet dhe konsultohet me manualin e sinjalistikës dhe skemat përkatëse dhe sipas kodit rrugor të R.SH. Në përfundim, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e OE “4-AM” Shpk, rezulton se *prima facia* metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht, të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike për kriterin “Koha e realizimit të punimeve” të kontratës që përfshin kohën e mobilizimit në kantier (jo më shumë se 3 muaj) dhe Grafikun e punimeve të kontratës. Gjithashtu edhe në lidhje me nënkriterin faktor favorizues subjekti “4-AM” Shpk përshkrim narrativ për metodologjinë që do të aplikohet në procedurat teknike të punës për këtë

projekt, por nuk evidentohet ndonjë pajisje apo metodologji specifike për të gjithë implementimin e projektit, që mund të kontribuojnë në një realizim më të shpejtë dhe me cilësi të lartë të projektit. Nga ana tjetër, KPP, referuar edhe informacionit të dhënë ënga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik i detajuar, mbi arsyen e vlerësimit me 5 nga 5 pikë maksimale të faktorit favorizues. Për më tepër, në bazë të informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor mbi “Faktori favorizues” për sa i përket një elementi të shtuar në lidhje me favorizimin e kohës së realizimit të punimeve dhe çdo aktivitet tjetër lidhur me të, Komisioni konstaton se, nuk kemi asnjë të dhënë apo material të përshkruar në këtë propozim teknik.

- Nga ana tjetër, parë në rrafsh krahasimor, metodologjia e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” Shpk, përbëhet nga: Përshkrim të projektit me të dhënat teknike dhe volumet e punimeve, Plani i mobilizimit, Organizimi i kompanisë+ Personeli kryesor +Disponueshmëria e pajisjeve kryesore, Menaxhimi mjedisor, shëndetit, sigursë dhe social, metodologjia e punimeve topografike, FV + transport i materialeve, metodologjia e punimeve të dheut, metodologjia e punimeve ndërtimore, kontrolli i cilësisë dhe tetsimet, pastrimi i kantierit dhe përgatitja e raporteve mujore dhe përfundimtare për punën e kryer. Konkretisht, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues “REJ” Shpk, rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, e cila përfshin metodat e përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit dhe çdo aktiviteti tjetër. Në rastin konkret, nga ana e operatorit ekonomik “REJ” Shpk, në përbushje të “nënkriterin/faktor favorizues” është paraqitur në SPE një material prej 71 faqësh “*Plani i mobilizimit dhe metodologjia e punimeve*”, ku evidentohet:

- Plani i mobilizimit ka për qëllim të shpjegojë sesi Kontraktori i Punimeve do të marrë masat për një mobilizim sa më të shpejtë dhe efikas që të zbatojë punimet për ndërtimin e objektit: Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të njësisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec, në përputhje me praktikat dhe standardet më të mira inxhinierike, kohën e vënë në dispozicion dhe buxhetin e propozuar;

-Përshkrim i projektit me objekt: “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, Njësia Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, është një investim i Ujësjiellës Kanalizimeve, për përmirësimin e kushteve egzistuese të rrjetit të kanalizimeve dhe projektimin e rrjetit të ri K.U.Z, në Njësinë Administrative Udenisht, Pogradec, për fshatrat Lin, Buqez, Piskupat, Udenisht, Memlisht. Nisur nga eksperiencat e mëparshme në zbatimin e punimeve për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve si dhe duke njohur mirë të dhënat e projektit gjykojmë të nevojshme një kohë mobilizimi prej 2 javësh në mënyrë që të sigurohet çdo bazë materiale dhe infrastrukturë tjetër e nevojshme për garantimin e të gjithë mbarëvajtjes së zbatimit të punimeve.

-Organigrama dhe një përshkrim të personelit kryesor dhe atij të kualifikuar (manovrator, shofera, mekanik, hekurkthyes,etj), të cilët do të jenë të angazhuar në terren për procesin e implementimit të projektit (ku cilësohet profili, si dhe fusha përkatëse e zbatimit) e kompletuar me profesionistë të të gjitha fushave që nevojiten për një mirëfunksionim të një kompanie që punon në fushën e ndërtimit. Në sajë të përvojës së tyre, si dhe shumëllojshmërisë së profileve inxhinierike dhe atij të

kualifikuar, kompania ofron zgjidhje teknike te gjitha situatave ndërtimore që mund të shfaqen gjatë impelmentimit të projektit të zbatimit.

-Një përshkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do të anagazhohen në implementimin e projektit të zbatimit, dhe të operacioneve të riparimit të segmenteve rrugorë, duke patur në konsideratë shumëllojshmërinë e punimeve, edhe mjetet që kërkohen për realizimin e tyre janë të shumëllojshëm.

-Një përshkrim të menaxhimit, ndërtimit të projektit të zbatimit dhe organizimit të punimeve, si dhe menaxhimit mjedisor dhe social, ku përshkruan veprimet themelore që do të ndërmerren gjatë aktiviteteve të ndërtimit për të shmangur, zvogëluar ose zbutur çdo ndikim në mjedis apo ndikimin social në zonën e ndikuar nga ky projekt. I gjithë personeli i projektit do të mbajë praktika të mira dhe do të zbatojë masat parandaluese dhe shmangie të përcaktuara në PMMS gjatë gjithë fazës së ndërtimit të projektit. Gjithashtu, Menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë dhe planet e zbatimit për të vendosur standardet e ndërtimit për të parandaluar dëmtimet, sëmundjet dhe vdekjen nga shkaqet që lidhen me punën dhe për të minimizuar humbjet e burimeve materiale dhe ndërprerjet nga ndodhjet aksidentale.

-Në lidhje me metodat e përdorura për punimet topografike, ku përfshihet rilevimi topografik do të përdoren për të prodhuar, brenda softuerit të projektimit të rrugëve, model të detajuar digjital të terrenit (DTM) dhe për të modifikuar shtrirjen horizontale dhe vertikale të shtrirjes së propozuar për të optimizuar sasinë e punimeve dhe prerjeve të terrenit. Rilevimi do të realizohet duke përdorur një GPS Rover (me teknologji GNSS) dhe Total Station. Do të vlerësohet mundësia e përdorimit, ku/nëse është e përshtatshme, të një Lazeri të Stacionit Total (që lejon matje pa prizëm) ose të Stacionit Total të integruar me GPS (Sistemi i Pozicionit Global) dhe me kapacitet për matjet RTK. Për piktimin e bazamenteve të strukturave dhe shtresave rrugore, çdo grup do të pajiset me marrës rover GPS me 2 frekuenca për piktime dhe rilevime me metoden RTK. Instrumentat do të jenë të pajisur me nga një pakete ekstra për punime rrugore. Opsion i mundshëm do të jetë automatizimi i makinerive të rënda me GPS. Grupet topografike do të kontrollojnë saktësinë e punimeve pas çdo faze pune të kryer nga makineritë e rënda. Pajisjet topografike (ose makineritë me GPS) do të kenë një stacion transmetimi bazë, i cili do të instalohet në kantier (Monument Kontrolli) me radio me valë të gjata për transmetimin e sinjalit RTK në të gjithë zonën e ndërtimit të objektit nga kilometri i parë deri tek i fundit.

-Një përshkrim të proceseve të punës për furnizimin, transport dhe magazinimin të materiale.

-Një përshkrim të metodologjisë së punimeve të dheut, përfshijnë gërmimet dhe punimet e dherave të kërkuara për projektin, veprat e artit, kanalizimet, etj. (gërmime të përgjithshme, në kanale dhe shkëmb, mikrotuneli, përforcimi i gërmimeve me palankola, gërmimet strukturore dhe mbushjet, mbushjet). Të gjitha punët nën këtë seksion do të jenë në përputhje me rreshtimin, gradat dhe detajet e paraqitura në pjesët tipike ose siç udhëzohen ndryshe.

-Një përshkrim të punimeve të tubave ku përfshin dorëzimin në kantier, magazinimin, shtrimin, bashkimin, lidhjet në rrjet, vënien në punë dhe testimin e tubacioneve dhe aksesoreve etj., të cilat duhet të përfundojnë plotësisht përpara lëshimit të Certifikatës së Përfundimit. Në lidhje me sigurimin e cilësisë, të gjithë tubat, veshjet dhe materialet e veshjes duhet të jenë të certifikuara për ujë të pijshëm (certifikatë e lëshuar nga një autoritet rregullator kompetent shëndetësor nga një vend që rregullon ligje të tilla) dhe nuk duhet të përmbajnë përbërës që mund të migrojnë në ujë

në sasi që konsiderohen të jenë toksike ose të rrezikshme për shëndetin. Në trajtimin e tyre, në paragrafin 10.4 të këtij materiali, subjekti i zbatimit do të përdorë hobe të miratuara dhe do të mbushen të gjitha grepat dhe kapjet e bulldogut dhe pajisje të tjera metalike. Materiali që do të përdoret në projekt zbatim, për të minimizuar rreziqet sanitare, prodhuesi duhet të jetë në gjendje të sigurojë një certifikatë që tregon se boja përfundimtare, e cila përdoret në veshjet e tubave prej hekuri duktil dhe është në kontakt me dherat dhe rrjedhjet, nuk përmban komponime organike të paqëndrueshme dhe bisfenol. Ndërsa në lidhje me Vendosja e tubave duhet të kryhet në mënyrë të sigurt, në përputhje me rregullat e sigurisë në fuqi dhe praktikat normale. Tubat e veshura duhet të trajtohen me hobe të përshtatshme, të cilat nuk dëmtojnë as tubin dhe as veshjen. Duhet të përdoret një numër i mjaftueshëm makinerish ngritëse (p.sh. booms anësore) për t'u siguruar që tubi nuk i nënshtrohet streseve të dëmshme. Në paragrafin 10.6.6. “prerja e tubave”, Prerja duhet të kryhet sipas udhëzimeve të prodhuesit, pa dëmtuar tubin ose veshjen mbrojtëse dhe për të lënë një fytyrë të lëmuar normale me boshtin e tubit. Të gjitha prerjet duhet të bëhen me mjete dhe pajisje prerëse të përshtatshme, por nuk cilësohet ndonjë pajisje e veçantë.

- Një përshkrim të metodologjisë së punimeve të betonit ku përfshin furnizimin e tij përfshirë të gjitha pajisjet, materialet, përzierjen e betonit, armaturat, armimi, vendosja, vibrimi dhe lagia e betonit, përfundimit të sipërfaqes së betonit dhe pastrimit të zones pas përfundimit të punimeve në përputhje me Specifikimet, Vizatimet dhe Udhëzimet e Supervizorit, sipas kushteve të kontratës.

- Një përshkrim të metodologjisë së punimeve të ndërtimit ku përfshin ndërhyrjet në shtresa asfaltike, edhe pse janë relativisht të vogla në krahasim me gjatësinë e total linjave, sërisht do t'i kushtohet një rëndësi e veçantë në trajtimin e tyre për riasfaltim. Mjetet që do të përdoren siç është ruli apo asfaltoshtuesja me të cilat do të kryhen proceset e punës, nuk evidentohet ndonjë pajisje inovatore.

- Një përshkrim të mbrojtjes së punimeve, mjedisit dhe publikut ku cilësohet se, meqë janë të disponueshme brenda një distance të arsyeshme nga punimet disa prej impianteve të licencuara dhe të aprovuara të klasës së specifikuar me sipër, do të lidhen kontrata pune me guroret/impianetet ekzistuese në afërsi të segmentit rrugor, duke shmangur në këtë mënyrë aktivitetet e ndërmjetme ndotëse në kantiere. Duke marrë në konsideratë numrin mesatar ditor të mjeteve që përshkojnë rrugën kryesore të fshatit Podgorie menaxhimi i devijimit të trafikut gjatë zbatimit të punimeve do të jenë kriteret udhëzuese për një realizim të suksesshëm, ekonomik dhe në kohë të të gjithë punimeve.

- Një përshkrim të kontrollit laboratorik, testim dhe kontrolli i cilësisë së materialeve, Kontraktori për të arritur objektivat kontraktuale dhe kërkesat e projektit në lidhje me cilësinë dhe procedurat përkatëse të cilat përfshijnë inspektime, do të përgatisë dhe do të azhurnojnë planet përkatëse të inspektimit dhe testimit (PTI-te) të cilat kërkohen për verifikimin dhe cilësinë e punimeve. Në përfundim, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e OE “REJ” Shpk, rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht, të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike për kriterin “Koha e realizimit të punimeve” të kontratës që përfshin kohën e mobilizimit në kantier (jo më shumë se 3 muaj) dhe Grafikun e punimeve të kontratës. Gjithashtu edhe në lidhje me nënkriterin faktor favorizues subjekti “REJ” Shpk përshkrim narrativ për metodologjinë që do të aplikohet në procedurat teknike të punës për këtë projekt, por nuk evidentohet ndonjë pajisje apo metodologji

specifike për të gjithë implementimin e projektit, që mund të kontribuojnë në një realizim më të shpejtë dhe me cilësi të lartë të projektit. Nga ana tjetër, KPP, referuar edhe informacioni të dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik i detajuar, mbi arsyen e vlerësimit me 5 nga 5 pikë maksimale të faktorit favorizues. Për më tepër, në bazë të informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor mbi “Faktori favorizues” për sa i përket një elementi të shtuar në lidhje me favorizimin e kohës së realizimit të punimeve dhe çdo aktivitet tjetër lidhur me të, Komisioni konstaton se, nuk kemi asnjë të dhënë apo material të përshkruar në këtë propozim teknik.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë (në rastet kur nuk aplikohet përlllogaritje me formulë) megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Në lidhje me vlerësimin e pikëve për këtë nënkriter, nga shqyrtimi i proces-verbalit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, si edhe analizuar në rrafshin krahasimor të dy propozimeve teknike për faktorin favorizues/pajisje inovatore që mund të kontribuojnë në një realizim më të shpejtë dhe me cilësi të lartë të projektit, si edhe të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues rezulton se, ku i fundit pretendon uljen e pikëve për subjektin “4-AM” SHPK, në lidhje me nënkriterin e faktorit “favorizues”, ku Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar me pikët e njëjta nga 5 pikë secilin pjesëmarrës. Në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e secilit pjesëmarrës si OE “4-AM” dhe “REJ” SHPK, është paraqitur një metodologji e përgjithshme në përmbushje të elementëve të propozimit teknik të kërkuar nga autoritetit kontraktor, Komisioni vlerëson se në bazë të informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor mbi “Faktori favorizues” për sa i përket një elementi të shtuar në lidhje me favorizimin e kohës së realizimit të punimeve dhe çdo aktivitet tjetër lidhur me të, Komisioni konstaton se, nuk kemi asnjë të dhënë apo material të përshkruar në këtë propozim teknik. Bazuar në këto propozime të dy operatorët janë vlerësuar me 5 pikë, për këtë nënkriter. Në këtë kontekst, Komisioni gjykon se, vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit teknik është i mjaftueshëm ndërsa argumenti i operatorit ekonomik ankimues për një vlerësim më të ulët për OE “4-Am” Shpk për këtë komponent nuk rezulton të jetë i bazuar. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesët, një vlerësim i arsyeshëm për të cilin Komisioni gjykon të mbetet i pandryshuar. Procesi i pikëzimit në procedurat e tilla duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik,

sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.11. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

c. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçantë të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime universitare [3 pikë]

Për sa më sipër në mbështetje të vendimit nr.1632/2024 datë 19.12.2024 dhe nr. 1719/2024 datë 06.12.2024 Autoriteti Kontraktor argumenton se: Dëshmi që stafi disponon diplomë universitare (bachelor + master) për stafin inxhinierik të Shoqërisë.

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë].

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit [6 pikë].

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi / reference / dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

**Shënim: Per përmbushjen e kriterit të mesipërme operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramen e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë të ndërtuar midis strukturave të njera-tjetrës, me mbikëqyrjen e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbejnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësive.*

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi vlerësimin me pikë për stafin kryesor të propozuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, çdo ofertues ka paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, atë kryesor, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara duke u shoqëruar me kontratat e punës, diplomat, Librezë pune, CV-të, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen qartë profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre.

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon diplomë universitare (bachelor + master) për stafin inxhinierik të Shoqërise [3 pikë].

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "4-AM" SHPK dhe "REJ" SHPK si edhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i kanë plotësuar kushtet e veçanta dhe janë vlerësuar të dy ofertuesit me 1 pikë. Gjithashtu, secili ofertues ka staf inxhinierik sipas profilit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, vërtetuar kjo me disponimin e diplomës universitare (bachelor + master) për stafin inxhinierik respektiv dhe janë vlerësuar të dy ofertuesit me 3 pikë.

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë].

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit [6 pikë].

Për të dy nënkriteret e sipërcituara, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "4-AM" SHPK dhe "REJ" SHPK, si edhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, Komisioni konstaton se ofertuesit kanë paraqitur dokument provues shoqëruar me Cv, librez pune, kontrata pune individuale dhe referenca pune, mbi stafin se disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin dhe eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. Në këto kushte, autoriteti kontraktor e ka vlerësuar secilin ofertues me pikë të barabarta. Pra, stafi kryesor i secilit operatori ekonomik ofertues i kualifikuar, me dokumentacionin e paraqitur, dëshmojnë se kanë kualifikime akademike, eksperiencë pune në vite si dhe eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. Lidhur me pretendimin e OE ankimues "REJ" Shpk mbi vlerësimin me më pak pikë për stafin kryesor të propozuar, të subjektit "4-AM" Shpk, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga dokumentacioni i paraqitur në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, atë kryesor, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara konstaton se ka më pak vitë eksperiencë në stafin teknik me profilet inxhinier ndërtimi, inxhinier hidroteknik, inxhinier topograf, inxhinier elektrik dhe inxhinier mjedisi. Për më tepër, duke krahasuar numërin e stafit teknik të propozuar, Komisioni konstaton se OE "REJ" Shpk ka paraqitur një numër më të lartë të stafit teknik në profilet inxhinier ndërtimi, inxhinier mekanik dhe inxhinier topograf. Sa

më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nisur nga dokumentacioni i OE ankimues, ku evidentohet se plotësohen dhe tejkalohen dukshëm kërkesat e autoritetit kontraktor i cili në rastin konkret nuk ka vendosur kufizime lidhur me eksperiencën e punonjësve, si edhe nga verifikimi i cv, diplomave, referencave të punës, autoriteti kontraktor duhej të pasqyronte vlerësimin me pikë të ndryshme nga ofertuesi “4-Am” Shpk, në lidhje me stafin teknik të propozuar. Pretendimi i ankimuesit për vlerësimin me më pak pikë të Oe “4-AM” Shpk, është i bazuar për sa kohë që gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nuk është evidentuar asnjë mangësi apo parregullsi, të cilat do të ndikonin në uljen e vlerësimit me pikë për këtë kriter. Një gjykim tërësisht subjektiv dhe të paarsyeshëm ka mbajtur edhe KSHA gjatë shqyrtimit të ankesës së OE ankimues duke mosargumentuar vlerësimin me pikë të barabarta për këtë kriter vlerësimi. KPP gjykon se një gjykim i tillë sipërfaqësor dëshmon se KSHA nuk ka analizuar në thellësi vitet e eksperiencës, numrin e stafit teknik të propozuar apo përvojat profesionale të secilit punonjës pjesë e stafit të OE ankimues të cilët rezultojnë të gjithë brenda profilit të kërkuar dhe me eksperiencë të konsiderueshme. Akoma më tej në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar asnjë minimum eksperience për asnjë punonjës ndërkohë eksperiencat e prezantuara të punonjësve të stafit të OE dëshmojnë për përvojë të gjatë profesionale. Komisioni sqaron autoritetin kontraktor, se, vlerësimi është i matshëm në kushtet kur, niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me stafin, duke përfshirë shumë elementë të tillë si numri i personelit, eksperiencë, profesionet, vitet e punës pranë shoqërisë, etj. Komisioni gjykon se vlerësimi dhe gjykimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime me pikë të barabarta, në kushtet kur, dukshëm operatori ekonomik ankimues provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion për stafin teknik të propozuar, me eksperiencë të konsiderueshme në krahasim me ofertuesit tjetër. Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e punëve, duhet të bëhet në përputhje edhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, vlerësimi i dhënë nga specialistët e KVO lidhur me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me stafin e kualifikuar në fushën e zbatimit në ndërtim, për operatorin ekonomik “4-AM” Shpk nuk është i arsyeshëm dhe jo në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ky i fundit, dhe për arsye duhet të kryejë rivlerësim me pikë për këtë ofertues.

b.- Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]
Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "4-AM" SHPK dhe “REJ” SHPK si edhe vendimt të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës duke përcaktuar në mënyrë të përgjithshme departamentet dhe personat përgjegjës të kompanisë. Ofertuesit kanë dëshmuar me dokumentacion metodologjinë e ndërveprimit midis

strukturave me njëra-tjetren, me mbikëqyrësin e punimeve dhe me autoritetin kontraktor si dhe kanë parashtruar argumentim mbi sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë dhe për arsye janë vlerësuar të dy ofertuesit me nga 2 pikë nga ana e autoriteti kontraktor. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, një vlerësim i arsyeshëm për të cilin Komisioni gjykon të mbetet i pandryshuar

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3.12. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. *[0-5 pikë]*
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. *[0-5 pikë]*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues dhe si edhe vendimit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar secili ofertues, në rastin konkret OE “4-AM” Shpk, një material prej 207 faqesh, ku kemi një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor mjedisor shqiptar si dhe qëllimi i planit të menaxhimit mjedisor, një përshkrim të procedurave të zbatuara nga kompania për zbutjen e efekteve negative, procedurat e monitorimit, auditim i zbatueshmërisë së sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social, një përshkrim checklist mbi procedurat e menaxhimit të çështjeve sociale i cili përfshin konsultimi dhe informimi i publikut, angazhimi i palëve të interesit, takimet publike, përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve, trajnime, propozime për përdorimin e materialeve, pajisjeve/makineri dhe procedura e menaxhimit të ankesave. Në këtë raport vihet re një përshkrim i përgjithshëm duke përshkruar ndikimet ndaj nivelit social, ajrit, zhurmave, ujit, florës, faunës, peisazhit dhe zonat e mbrojtura. Në raport vihet re një përshkrim i masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit, plani i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Referuar informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor mbi propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social për sa i përket propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike, Përdorimi i makinerive/pajisjeve ekologjike dhe propozime konkrete për përmirësime

të ekonomisë lokale të zonës ku do të kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve, Komisioni konstaton se, nuk kemi asnjë të dhënë apo material nga ana e OE “4-AM” Shpk. Konkretisht, në kapitullin 12 “Propozime për përdorimin e materialeve, pajisjeve dhe makinerive miqësore me mjedisin”, Komisionin evidenton se, kemi një përshkrim të përdorimit me eficiencë të të makinerive që kanë të bëjë me Sistemin e Menaxhimit të Flotës së Makinerive dhe ky sistem ndihmon kontraktorët të optimizojnë performancën e makinerive dhe të ulin koston e karburantit dhe emetimeve në ajër. Sipas materialit të hartuar nga OE “4-AM” Shpk, ky sistem maksimizon efikasitetin e përdorimit të mjeteve dhe minimizon ndotjen e ambjentit. OE ofertuese ka synimin e përdorimit të makinerive të reja, të cituar në këtë material, por Komisioni nuk evidenton se cilat janë këto makineri/pajisje ekologjike për uljen e ndikimit në mjedis.

Ndërsa, operatorit ekonomik ankimes "REJ" SHPK ka dorëzuar një material prej 71 faqësh *“Plani i mobilizimit dhe metodologjia e punimeve”*, ku evidentohet kapitulli 5.2. *“Menaxhimi Mjedisor Dhe Social”* ku kemi një përshkrim objektivave, të cilat ofertuesi gjykon se, do të sigurojnë kornizat mbi të cilat, OE “REJ” Shpk është në gjendje të japë një angazhim të vendosur për të siguruar rezultate të sigurta të cilësisë së lartë dhe mjedisore të shëndoshë në gjithçka që bëjmë. OE “REJ” Shpk për të siguruar arritjen e këtyre qëllimeve dhe për të përmirësuar vazhdimisht efektivitetin e sistemit, objektivat dhe synimet e matshme, do të zhvillohen dhe rishikohen në baza të rregullta. Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social zbaton masat e përshtatshme zbutëse bazuar në identifikimin e ndikimit në vlerësimin mjedisor dhe social dhe monitorimin e efektivitetit të këtyre masave brenda ciklit të jetës së projektit. Ndërsa në kapitullin 9 *“metodologjia e punimeve të dheut”*, kemi një përshkrim të proceseve të punës në drejtim të kontrollit të zhurmave, pastrimi i kantierit dhe mbrojtja nga uji. Nga informacioni i dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ashtu edhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, për këtë komponent vlerësimi, i kanë dhënë 0 pikë ofertuesit “REJ” Shpk. Nga shqyrtimi i mënyrës së hartimit të këtij kriter vlerësimi me pikë, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një format apo model të caktuar të propozimeve për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social. Nga materiali i propozuar i OE “REJ” Shpk në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor të metodologjisë për minimizimin e ndikimit në mjedis dhe atij social, Komisioni konstatoi se ka bërë një përshkrim të objektivave në këtë drejtim, por Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ashtu edhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nuk mund të vlerësojë me 0 pikë duke argumentuar se nuk merr asnjë informacion në bazë të dokumentave të propozimit teknik të ngarkuar në SPE. Nga faktet e paraqitura, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor duhet të rivlerësojë OE “REJ” Shpk për këtë komponent vlerësimi me pikë, duke iu referuar dokumentacionit konkret të ngarkuar nga ofertuesi në SPE, dhe duke gjykuar nëse materiali i propozimit teknik të këtij ofertuesi, përmbush apo jo në mënyrë shteruese, kërkesat e autoritetit kontraktor, por nuk mund të themi se nuk merret asnjë informacion në lidhje me aspektin e mbrotjes së mjedisit.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e OE “REJ Shpk për mospërmbushje të këtij kriteri nga ana e ofertuesit “4-AM” Shpk, Komisioni konstaton se, nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE dhe informacioni i dhënë nga ana e autoritetit kontraktor, ofertertuesi “4-AM” ka dorëzuar një material prej 207 faqësh, për këtë kriter. Konkretisht, në lidhje me këtë kriter kemi Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale

që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “4-AM” SHPK janë përcaktuar dhe përshkruar masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit të projektit për minimizimin e ndikimeve në mjedis si dhe është specifikuar materialet dhe lënda e parë të cilat do të blihen të cilësisë më të lartë dhe ekologjike me mjedisin. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga OE “4-AM” Shpk, është paraqitur hyrja, qëllimi i projektit, si dhe një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor. Në këtë raport, vihet re një përshkrim i përgjithshëm i projektit kryesisht për hapat që ndiqen gjatë implementimit të projekt zbatimit për ndërtimin e ujësjellësit, si dhe përshkrim i përgjithshëm i komponentëve të mjedisit si flora, fauna, ajër, ujë dhe klima, ndikimi i aktivitetit të zhvillimit të projektit në komponentët mjedisorë si dhe masat rehabilituese. Në këtë raport vihet re një përshkrim i përgjithshëm duke përshkruar ndikimet ndaj nivelit social, ajrit, zhurmave, ujit, florës, faunës, peisazhit dhe zonat e mbrojtura.

Në lidhje me Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë], nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesit e kualifikuar, si dhe nga argumentimi i dhënë nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se operatori ekonomik “REJ” Shpk ka paraqitur propozime konkrete të tilla si punësime të banorëve të zonës përreth ku do të zhvillohet projekti, si dhe të atyre që janë forcë punëtore të pakualifikuar për procese pune të thjeshta, trajnim i stafit apo teknikë të punësuar të zonës që të mësojnë proceset e punës, duke i kualifikuar ata.

Në këtë kontekst, Komisioni gjykon se, vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit mjedisor dhe social, është mirëargumentuar në përputhje me materialet e paraqitura prej ofertues “4-AM” Shpk, ndërsa pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” Shpk, për uljen e pikëve për ofertuesin “4-AM” SHpk, për këtë komponent rezulton të jetë i pabazuar, parë kjo në rrafshin krahasimor të parashtruar më lartë në argumentim. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi “4-AM” Shpk, një vlerësim që është mirëargumentuar në detaje. Procesi i pikëzimit në procedurat sistem pikëzimi, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023,

“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” Shpk, për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt *“Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”* me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e katër), zhvilluar në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini
Kryetar			
Jonaïd Myzyri			

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik OE “REJ” SHPK konkretisht nuk jam dakord me arsyetimin në pikën III.3 e në vijim, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “REJ” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt “*Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec*” me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion milion peseqind e dyzet e pese mijë e njeqind e nentedhjet e te pike tridhjet e kater), zhvilluar në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “4 A-M” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “4 A-M” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj:

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “REJ” SHPK duke kundërshtuar vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “4-AM” Shpk, me argumentin se: “*...Duke qënë të bindur se vlerësimi i ofertës tonë me 258.90 pikë nuk paqyron vlerësim të drejtë nga ana e KVO për ofertën tonë në raport me dokumentacionin e parqitur si dhe vlerën e ofertës të ofertuar nga ana jonë, po i drejtohem më këtë ankim AK dhe KP, duke kundërshtuar*

vendimin mbi vlerësimin e ofertës tone me 258.90 pikë dhe kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit 4 AM shpk me 299.50 pikë.

Ndërsa vlerësimi për nënkriterin “b” Faktorët Favorizues, oferta e Rej shpk është vlerësuar në total me 5 pikë dhe po me 5 pikë është vlerësuar oferta e shoqërisë “4AM” shpk. Vlerësimi me 5 pikë i ofertës së operatorit “4AM” shpk është i padrejtë dhe subjektiv pasi ky subjekt nuk ka paraqitur me dokumentacion asnjë risi, faktor favorizues ose ndonjë pajisje inovative si dhe paraqitjen e ndonjë metodologjie punimesh që të favorizojë kohën në realizimin e punimeve,

-Operatori ekonomik 4AM shpk ka dështuar të plotësojë këtë kërkesë pasi nuk ka paraqitur një analizë të mirëfitlltë të makinerive që do të angazhojë për secilin proces pune ose më e pakta ajo analizë që ka dorëzuar nuk plotëson kushtet për tu pikëzuar me maksimumin e pikëve. Gjithashtu e njëjta gjë vlen edhe për analizën për numrin e përafërt të punonjësve që do të angazhjë në cdo proces pune,

-gjykojmë se subjekti 4AM shpk duhet të vlerësohet me pikë

me pak se operatori Rej shpk lidhur me nënkriterin e pikës 2 “Dëshmi që stafi disponon kualifikime universitare [3 pikë]” pasi operatori 4AM shpk nuk ka paraqitur staf i cili përveç diplomimit të këtë kryer dhe kualifikime universitare në fushat përkatëse që kanë lidhje me objektin e prokurimit.

-Subjekti 4AM shpk duhet të vlerësohet me pikë me pak se operatori Rej shpk lidhur me nënkriterin e pikës 3 “Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit [3 pikë]” pasi operatori 4AM shpk ka paraqitur staf i cili referuar viteve në punë kanë më pak vite eksperiencë punë se stafi i paraqitur nga operatori Rej shpk.

Kësisoj për këtë nënkriter operatori ekonomik 4AM shpk duhej të vlerësohej me pikë minimale dhe jo maksimale. Gjithashtu, Subjekti 4AM shpk duhet të vlerësohet me pikë me pak se operatori Rej shpk lidhur me nënkriterin e pikës 4 “Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashmerise me kontratën që prokurohet [6 pikë]” pasi operatori 4AM shpk ka paraqitur staf i cili referuar natyrës së punës apo kompleksitet të ngjashmerisë me natyrën e kontratës që prokurohet nuk kanë asnjë gjë të përafërt apo të përbashkët. Kësisoj për këtë nënkriter operatori ekonomik 4AM shpk duhej të vlerësohej me pikë minimale dhe jo maksimale. Lidhur me nënkriterin e pikës “b4” dhe të fundit për këtë kriter “Skema e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0-2 pikë]”, rezulton se operatori 4AM shpk duhej vlerësuar me pikë minimale për këtë nënkriter pasi ka një mospërputhje ndërmjet mungesës së përvojës lidhur me vitet dhe eksperiencën së stafit dhe nuk mund të këtë një skemë organizimi të tyre që të meritojnë maksimumin e pikëve.

- Ne jemi të bindur se OE 4AM shpk nuk ka dorëzuar fare dokumentacion për nënkriterin “a” e “b” të kësaj pikë, ose edhe nëse ka dorëzuar dokumentacion ai nuk i përgjigjet propozimeve konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore si dhe propozimeve konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve....”,

III.3 Referuar përcaktimeve ligjore, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Theksoj se kriteret për kualifikim vendosën që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si Çmimi (50 pikë), Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit (20 pikë), Stafi/organizimi i kompanisë (15 pikë), Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social (0-10 pikë), Periudha e garancisë së objektit (0-5 pikë) sipas dokumenteve standarde të tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “REJ” shpk, i cili ka kontestuar vlerësimin e stafit kryesor të propozuar nga operatori ekonomik “4-AM” shpk, duke pretenduar se ky i fundit është vlerësuar në mënyrë të gabuar me më shumë pikë nga autoriteti kontraktor, pavarësisht se sipas ankimuesit, eksperiencë dhe cilësia profesionale e stafit të propozuar nuk përmbush të njëjtin nivel kompleksiteti dhe përputhshmërie me kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit, vlerësojmë sa vijon:

Bazuar në nenin 108 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM 285 / 2021 “Miratimin e Rregullave të Prokurimin Publik”, operatori ekonomik që ushtron të drejtën e ankesës është i detyruar të mbështesë pretendimet e tij me fakte konkrete, prova të drejtpërdrejta dhe/ose një analizë të detajuar të bazuar në të dhëna objektive, të cilat shërbejnë për të provuar në mënyrë të qartë dhe të paanshme cenimin e pretenduar të të drejtës ose interesit të tij legjitim. Ky parim është i njohur si “**barra e provës**” dhe përbën një standard juridik themelor në procesin e shqyrtimit të ankesave administrative.

Nga analiza e dokumentacionit të ankesës rezulton qartësisht se operatori ekonomik “REJ” shpk, në përmbajtjen e pretendimit të tij, nuk ka paraqitur asnjë provë dokumentare të natyrës teknike ose profesionale, referenca për punë të kryera, dokumentacion që të dëshmojë rolin dhe kontributin e ekspertëve të propozuar, analiza krahasimore të dokumentuara për përvojën dhe kapacitetin profesional, të cilat të provojnë se vlerësimi i bërë nga autoriteti kontraktor është i gabuar, i pabazuar apo i paarsyeshëm.

Në mungesë të fakteve konkrete dhe të analizës krahasimore të bazuar në të dhëna objektive, pretendimi i paraqitur nuk plotëson standardin ligjor të barrës së provës dhe konsiderohet i pambështetur, si në aspektin formal procedural, ashtu edhe në përmbajtjen materiale të tij.

Për më tepër, duhet të theksohet se vlerësimi i eksperiencës së stafit teknik, sipas legjislacionit të prokurimit publik dhe praktikës së qëndrueshme të Komisionit të Prokurimit Publik, nuk kryhet vetëm mbi bazën e numrit të viteve të punës të ekspertëve të propozuar, por është një proces thellësisht cilësor dhe profesional, i cili merr në konsideratë disa elemente themelore si:

- natyra dhe kompleksiteti i punimeve të realizuara më parë;
- përputhshmëria specifike e përvojës së ekspertit me objektin dhe kërkesat teknike të kontratës që do të realizohet;
- roli konkret që eksperti ka pasur në projektet e mëparshme;
- rezultatet e arritura, niveli i përgjegjësisë dhe ndikimi i drejtpërdrejtë në projektet e realizuara.

Në këtë kontekst, vetëm deklarimi i viteve të eksperiencës nuk përbën tregues absolut për të vlerësuar aftësinë profesionale të një eksperti, pasi vlerësimi duhet të orientohet drejt analizës së thelluar të përvojës reale dhe përputhshmërisë së saj me kërkesat specifike të kontratës.

Rrjedhimisht, një ekspert me më pak vite eksperiencë por me angazhim në projekte të një niveli të lartë kompleksiteti dhe të ngjashme me objektin e kontratës së tenderuar, mund të marrë vlerësim më të lartë profesional sesa një individ me më shumë vite eksperiencë, por pa angazhim në projekte të natyrës dhe nivelit të kërkuar.

Ky standard profesional bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe cilësisë në vlerësim, si dhe në parimet themelore të ligjit për prokurimin publik, përfshirë transparencën, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe vlerësimin real të kapaciteteve profesionale në funksion të interesit publik.

Për të gjitha sa më sipër, arrihet në përfundimin juridik dhe teknik se pretendimi i operatorit ekonomik “REJ” shpk rezulton i pambështetur në fakte, dokumente apo analiza teknike që të provojnë se stafi i “4-AM” shpk është vlerësuar në mënyrë të gabuar. Mungesa e provave dhe e një analize të detajuar e bën këtë pretendim të papranueshëm si në aspektin procedural, ashtu edhe në aspektin material, duke e konsideruar të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e bërë nga autoriteti kontraktor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikatat e konsoliduara të vlerësimit profesional të stafit teknik.

Si rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK **nuk qëndron**.

III.3.12. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Në lidhje me vlerësimin e kriterit “Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis Social”, rezulton se operatori ekonomik ankimues “REJ” shpk ka paraqitur në ofertën e tij një dokument me përmbajtje të përgjithshme dhe deklarative, i cili nuk plotëson standardet teknike dhe përmbajtësore të kërkuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Bazuar në dokumentacionin përkatës të tenderit, kriteri në fjalë përbëhet nga katër shtylla vlerësimi, të cilat kërkojnë një analizë të qartë, të strukturuar dhe të matshme mbi ndikimin që projekti do të ketë në aspektin social dhe mjedisor, përfshirë:

1. Strategjitë për përfshirjen e komunitetit lokal,
2. Masa konkrete për minimizimin e ndikimeve negative,
3. Promovimi i punësimit lokal dhe përfitimeve sociale,
4. Mekanizma monitorimi dhe raportimi të ndikimit gjatë dhe pas zbatimit të kontratës.

Në këtë kontekst, operatori ekonomik ankimues, përveçse nuk ka strukturuar dokumentin sipas shtyllave të kërkuara, nuk ka ofruar asnjë indicie konkrete mbi mënyrën e përmbushjes së këtyre

elementeve. Dokumenti i paraqitur është i karakterit të përgjithshëm, i mbushur me formulime të natyrës teorike dhe deklarative, pa referenca konkrete, objektiva të matshme apo përshkrime të instrumenteve të zbatimit në praktikë.

Gjithashtu, vlerësimi me 0 pikë nga autoriteti kontraktor është i justifikuar dhe përputhet plotësisht me kompetencën diskrecionale teknike të autoritetit, e cila në këtë rast është ushtruar mbi bazën e kritereve të qarta të vendosura më parë dhe në trajtim të njëjtë me operatorët. Kjo lëvizje është në përputhje me parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë, të garantuar nga i Ligji i Prokurimit Publik.

Sipas praktikës së qëndrueshme të Komisionit të Prokurimit Publik, çdo element i vlerësimit teknik që nuk është i qartë, i dokumentuar dhe i matshëm, nuk mund të konsiderohet si përmbushje e kritereve të kërkuara, dhe rrjedhimisht meriton vlerësim minimal ose zero, në varësi të shkallës së mungesës. Në këtë rast, mungesa e strukturimit sipas katër shtyllave, mungesa e përshkrimit të masave konkrete dhe mungesa e çdo indikacioni të matshëm në dokumentin e paraqitur, justifikon vlerësimin me 0 pikë.

Në përfundim, autoriteti kontraktor ka vepruar drejtë dhe brenda kufijve të ligjit dhe dokumentacionit të tenderit, duke vlerësuar me 0 pikë propozimin për ndikimin në mjedis social të paraqitur nga “REJ” shpk, për shkak të mungesës së qartësisë, konkretizimit dhe përputhshmërisë me kërkesat e tenderit. Ky vlerësim është ligjërish i qëndrueshëm dhe teknikisht i justifikueshëm.

Si rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK **nuk qëndron**.

Nisur nga arsyetimi i bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 34, 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj:

1. Të mos pranohet ankesa e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-24488-10-14-2024, me objekt “Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë Administrative Udenisht, Bashkia Pogradec” me fond limit: **1.003.545.198,34** (një miliard e tremilion milion pesëqind e dyzet e pese mijë e njëqind e nentëdhjetë e tetë pike tridhjetë e katër), zhvilluar në datën 24.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Pogradec.

Anëtar

Kreshnik Ternova

